

## I. PËRCAKTIME

**I Siguar** - Individu(ët) e emërtuar si të Siguar në Listën e të Siguarve ose në ndryshime të mëvonshme të saj, të moshës 18 deri 70 vjeç në datën e fillimit të Policës. Të Siguarit që arrijnë moshën 70 vjeçare gjatë periudhës së sigurimit, do të mbulojnë deri në përfundim të kësaj periudhe.

**'Policëmbajtës/ Kontraktues'** - Punëdhënësi i përcaktuar si Kontraktues në Formularin e Policës.

**'Aksident' ose 'Aksidental'** – Përcaktohet çdo ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh në mënyrë rastësore pa vullnetin e të Siguarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të Siguarin dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë ose dëmtime trupore të të Siguarit. Do të konsiderohen aksidente edhe :

*Helmimi akut i pavullnetshëm ose djegie të pavullnetshme që vijnë si shkak i gëlltitjes ose rënies në kontakt me substanca toksike ose gërryese dhe gazrave apo avujve toksikë, përveç sëmundjeve profesionale; Goditjes elektrike (ku përfshihet edhe goditja nga rrufeja); Asfiksia, mbytja, ngrirja, goditja e diellit përfshirë plagët e shkaktuara nga rrezet ultraviolett por jo djegia nga dielli; Shkëputjet ose ndrydhjet muskulare që vijnë si shkak i sforcimit fizik; Trazirat civile masive apo aktet terroriste, me kusht që i Siguarit të mos ketë marrë pjesë aktive në to; Rastet e infeksioneve të shkaktuara nga plagët e një aksidenti, si edhe infeksionet nga tetanozi apo tërbimi; Rëniet nga lartësitë.*

**'Dëmtim Trupor Aksidental'** – Dëmtim trupor që pëson i Siguarit brenda periudhës së Policës, që shkaktohet vetëm dhe drejtpërdrejt nga mjete Aksidentale (duke përfshirë sëmundjet ose çrregullimet shëndetësore) dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës ose paaftësinë e plotë të përhershme për punë të të Siguarit brenda 12 muajve kalendarikë nga data e Aksidentit.

**'Paaftësi e plotë e përhershme'** paaftësia që e ndalon plotësisht të Siguarin për të ushtruar profesione/punësime për të cilat është i aftë nga arsimimi, trainimi ose përvoja, dhe që zgjat të paktën 12 muaj të pandërprerë dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë për mirësimi.

**Semundje Akute** - konsiderohen Atak në zemër (infarkt akut i miokardit), Goditje në tru (stroke / hemorragji intracerebrale), Insuficiencë akute e veshkave.

**'Policë sigurimi'**- këto kushte, Formulari dhe çdo shtojcë ose ndryshim i mëvonshëm i nënshkruar nga Siguruesi

**'Përfitim'** – shuma përkatëse e sigurimit ose pjesë të saj siç përcaktohet në Formularin e Policës dhe Tabelën e Përfitimeve, e pagueshme nga Siguruesi në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Police për çdo ngjarje ose dëmtim që mbulohet nga kjo Policë.

**'Gjendje Para-ekzistuese'** – çdo semundje, plagë ose ngjarje që është anomali kongjenitale, gjenetike apo e fituar, përpara datës së hyrjes në sigurim dhe e cila është diagnostifikuar nga një mjek qoftë përpara apo pas hyrjes në sigurim; (kjo e vërtetuar me dokumentacion mjekësor apo ekspertizë mjekësore), apo ka kërkuar trajtim mjekësor para datës së hyrjes në sigurim, duke përfshirë këtu edhe marrjen e ilaçeve, apo çdo sëmundje, plagë, ose ngjarje që ka shfaqur simptoma përpara datës së fillimit të policës, pavarësisht nëse i siguarit kishte apo nuk kishte dënim.

## II. OBJEKTI I MBULIMIT ME SIGURIM

Në përputhje me parashikimet e kushteve të përgjithshme dhe Tabelës së Përfitimeve, shoqëria e sigurimeve **SIGAL Insurance Group**, Pashko Vasa p.n Prishtine (këtu më poshtë do të quhet 'SIGAL' ose 'Siguruesi') do të paguajë kompensim financiar për intervenim kirurgjik dhe hospitalizim si pasojë e semundjeve akute, kompenzim financiar për shpenzimet mjekësore, lëndimet, frakturat dhe djegiet si pasojë e aksidentit, kompenzim financiar për paaftësi të plotë të përhershme dhe humbjes së jetës që mund të rezultojë si pasojë e një aksidenti ose dëmtimi aksidental të pësuar nga i siguarit, gjatë periudhës së sigurimit të treguar në policë dhe për të cilën ky sigurim është i vlefshëm.

## III. PËRJASHTIME TË MBULIMIT NË SIGURIM

SIGAL nuk do të mbulojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë apo dëmtime trupore të të Siguarit që janë rrjedhojë direkte ose indirekte e:

- luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes ose masat për qetësimin e tyre;
- përmbytjes, zhvendosjes së tokës, shpërthimeve vullkanike, tërmeti, katastrofave natyrore;
- qëndrimit në zona klimaterike të rrezikshme ose pjesëmarrjes në ekspedita për qëllime shkencore ose për qëllime të tjera;
- praktikimit nga ana e të Siguarit të veprimtarive profesionale sportive (gara apo stërvitore) të cilat nuk janë deklaruar si profesione;
- praktikimit të sporteve siç janë skijimi, ngjitjet (hiking), hedhjet nga trampolina dhe sporte të tjera të ngjashme.
- pjesëmarrjes së të Siguarit në gara apo konkurime sportive të mjetit motorik apo lundrues, qoftë drejtues, pjesëtar i ekuipazhit apo pasagjer;
- përdorimit të një mjete fluturimi me ose pa motor, qoftë drejtues apo anëtar i ekuipazhit të tij;
- të gjitha llojeve të sëmundjeve;
- përdorimit të alkoolit, për shkak të dehisjes, përdorimit të drogës apo substancave halucinatave apo abuzimit me substanca kimike (ilace ose droga);

- j. përkeqësimet e shëndetit për shkak të trajtimeve mjekësore, terapive, injeksioneve, ndërhyrjeve kirurgjikale, kurimit apo kontrolleve për pasoja që nuk janë shkaktuar nga aksidentet;
- k. vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje ose akteve të kryera me dashje apo të tentuara nga i siguruari edhe nëse personi nuk është i përgjegjshëm në momentin e ndodhjes së aktit;
- l. dëmtimeve të shkaktuara vetvetes edhe nëse personi nuk është i përgjegjshëm në momentin e ndodhjes së aktit;
- m. ekspozimit ndaj të gjitha llojeve të radiacionit pavarësisht nga origjina e shkaktimit të tyre;
- n. e aksidenteve apo sëmundjeve të ndodhura/shkaktuara përpara datës së fillimit të mbulimit në sigurim;
- o. ndikimit të problemeve mendore apo çdo lloj defekti fizik apo mendor i të siguruarit që nuk është shkaktuar nga aksidenti gjatë periudhës së siguruar;
- p. sindroma e deficiencës Imunitare të fituar (HIV/AIDS) dhe gjendjeve shëndetësore të lidhura me të;
- q. gëllitjes, thithjes apo injektiveve të vullnetshme të substancave farmaceutike, kimike, apo drogave pa autorizim nga mjeku;
- r. pjesëmarrjes së të Siguruarit në zënka dhe grindje; përfshirjes ose tentativës së kryerjes nga ana e të siguruarit në aktivitete të paligjshme, kriminale apo keqbërëse.
- s. sëmundjet, gjendjet dhe ngjarjet paraekzistuese dhe të lindura;
- t. shpenzimet mjekësore për pandemitë dhe epidemitë të shpallura si të tilla nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës ose institucionet tjera relevante shëndetësore në Kosovë të autorizuara me ligj si ose nëse të njëjtat janë të përcaktuara si të tilla me legjislacionin në fuqi për sëmundjet ngjithëse në Kosovë.
- u. shpenzimet mjekësore si pasojë e fatkeqësive natyrore, aksidenteve ekologjike, aksidenteve industriale dhe fatkeqësive tjera sipas definimit ligjor të përcaktuar me ligjin në fuqi në Kosovë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- v. shpenzimet mjekësore si pasojë ose rezultat i alkoolit ose alkoolizmit;
- w. paaftësinë e përkohshme;
- x. të gjitha gjendjet që nuk janë të përcaktuara si mbulime.

#### IV. PËRFITIMET

1. **Përfitimi në rast humbje jete** – Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë humbjen e jetës, Siguruesi me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme do t'i paguajë Përfituesit vlerën e përfitimit të barabartë me 100% të shumës së sigurimit të përcaktuar në Policën e Sigurimit.
2. **Përfitimi në rast paaftësie të përhershme** – Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari pëson Dëmtim Trupor Aksidental me pasojë Paaftësinë e përhershme të plotë të përshkruara në Tabelën e Përfitimeve, atëherë Siguruesi, me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme, do të paguajë shumën përkatëse të përfitimit sipas Tabelës së Përfitimeve.  
Në rast të paaftësisë së përhershme jo të treguar në tabelë, përfitimi përcaktohet duke pasur parasysh shkallën e humbjes së aftësive normale fizike dhe mendore të të Siguruarit, pavarësisht nga profesioni i tij/saj.
3. **Përfitimi në rast lëndimi , frakture, djegje si pasojë e aksidentit mbulohe 100% deri në limitin maksimal të përcaktuar në policë.**
4. **Përfitimi në rast të semundjes akute** - Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi, i Siguruari ka nevojë për intervenim kirurgjik dhe hospitalizim si pasojë e semundjes akute (semundjet akute të specifikuar në nenin një (1) të kontratës), ai/ajo do të përfitojë kompensim financiar për shumën sipas limitit të përzgjedhur në këto kushte ose të përcaktuar në policë. Semundje akute janë Atak në zemër (infarkt akut i miokardit), Goditje në tru (stroke / hemorragji intracerebrale), Insuficiencë akute e veshkave.  
Për mbulimin e Semundje Akute periudha pritëse e aplikueshme është tre (3) muaj nga dita e nënshkrimit të policës/kontratës.

#### V. PROCEDURA PËR KËRKESA PËR PAGESË

1. **Njoftimi i ngjarjes së Sigurimit** – Çdo ngjarje ose dëmtim që mund të çojë në një kërkesë për pagesë/përfitim sipas kësaj police, duhet t'i njoftohet me shkrim SIGAL brenda 5 ditësh nga ndodhja. Mosnjoftimi brenda periudhës kohore të parashikuar më sipër nuk do ta bëjë të pavlefshme kërkesën për përfitim nëse provohet se nuk ka qenë e mundur dhënia e njoftimit dhe se njoftimi është dhënë sapo ka qenë mundësuar në mënyrë të arsyeshme.  
I siguruari ose Kontraktuesi duhet sa më shpejt që të jetë e mundur të kontaktojë një mjek të kualifikuar për të marrë kujdesin e duhur mjekësor, të ndjekë këshillat dhe rekomandimet e mjekut dhe ato të Siguruesit si dhe duhet të bëjë përpjekje maksimale për të minimizuar pasojat e aksidentit dhe semundjet akute.
2. **Kërkesa për kompensim/pagesë** - I Siguruari ose Përfituesi paraqet kërkesën për komensim së cilës duhet t'i bashkëngjiten të gjithë dokumentet e nevojshme që vërtetojnë Rastin e Sigurimit, pasojat dhe dëmtimet në aksident.  
I Siguruari ose Përfituesi duhet të paraqesë në çdo rast dhe jo më vonë se 30 ditë nga lëshimi i tyre, dokumentet mjekësore, certifikatat mjekësore apo çdo lloj dokumentacioni tjetër që lidhet me aksidentin dhe/ose semundjet akute e që do t'i kërkohet nga Siguruesi. Shpenzimet për marrjen e dërgimin e dokumenteve mbulohe nga i Siguruari.  
SIGAL paguan përfitim për pasojat e drejtpërdrejta dhe ekskluzive të shkaktuara nga semundja akute, aksidenti i ndodhur brenda periudhës së sigurimit.  
SIGAL do të ketë të drejtë por jo detyrim, që me shpenzimet e tij t'i kërkojë të Siguruarit të kryejë kontrolle mjekësore gjatë shqyrtimit të kërkesës për përfitim.

3. **Pagesa e përfitimit** - Siguruesi do ta trajtojë Kontraktuesin/Policëmbajtësin (punëdhënësin) si përfaqësuesin ligjor përfitues të kësaj Police dhe çdo shumë e pagueshme sipas kësaj Police do të paguhet në përputhje me kërkesën dhe udhëzimet e Kontraktuesit dhe pagesa e kryer në këtë mënyrë do ta çlirojë Siguruesin nga çdo përgjegjësi e mëtejshme për përfitimin në fjalë.
- Nëse kryhen kërkesa për përfitim që janë mashtruese në ndonjë aspekt, ose Kontraktuesi apo i Siguruari apo përfaqësues që veprojnë në emër e për llogari të tyre përdorin mjete ose metoda mashtrimi për të përfituar pagesa sipas kësaj Police, atëherë SIGAL nuk do të ketë përgjegjësi për pagesën e këtyre kërkesave.
- Çfarëdo pagesë e kryer në emër të kompensimit gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate/police do të zbritet nga shuma e siguruar.

## VI. KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi për aq sa ofron mbulim sigurimi nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikuashëm për palët e kësaj kontrate. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

## VII. PARASHIKIME TË TJERA

**Fillimi dhe Përfundimi i mbulimit me sigurim** – Kjo policë hyn në fuqi ditën e shënuar në Formularin e Policës si data e fillimit të periudhës së sigurimit. Kjo Policë do të mbulojë automatikisht në sigurim të gjithë punonjësit e rinj të Kontraktuesit (nëse kontraktuesi është punëdhënësi) nga data e fillimit të punësimit, në varësi të njoftimit që i bën Kontraktuesi Siguruesit brenda 10 ditësh nga fillimi i punësimit. Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës për të dëmshpërblyer dëmet për punonjësit e pa njoftuar nga Kontraktuesi.

Mbulimi në sigurim për të Siguruarin do të përfundojë me ndodhjen e më të hershmes të njëjës prej ngjarjeve të mëposhtme: Përfundon periudha e sigurimit në datën e treguar në policë;

- Përfundon periudha e sigurimit në datën e treguar në policë;
- Data në të cilën i Siguruari përfundon marrëdhënien e punës me Kontraktuesin;
- Pas pagesës së përfitimit maksimal.

**Pagesa e Primit të Sigurimit** – Primi i sigurimit paguhet i plotë ose me këste, sipas datave të përcaktuara në Policën e sigurimit. Nëse primi nuk paguhet si më sipër atëherë kjo Policë bëhet e pavlefshme dhe mbulimi i dhënë prej saj konsiderohet i pavlefshëm nga data e lëshimit të policës.

**Kufijtë gjeografikë** – Mbulimi i dhënë nga kjo policë është i vlefshëm brenda kufijve territorial të Republikës së Kosovës. Siguruesi dhe Kontraktuesi mund të bien dakord që të zgjerojnë kufirin gjeografik të mbulimit, duke nënshkruar një aneks shtesë.

**Anulimi i policës së sigurimit**- SIGAL ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit për shkak të njoftimeve e deklarimeve të pasakta të kryera me qëllim nga i Siguruari ose Policëmbajtësi. Në këtë rast Policëmbajtësi ka të drejtën e pjesës së primit për periudhën e mbetur, duke zbritur shpenzimet administrative.

SIGAL ka të drejtë të zgjidhë Policën e Sigurimit në rast se Policëmbajtësi nuk paguan primin ose këstin e tij në përputhje me afatet e përcaktuara në policë.

Policëmbajtësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Policës së Sigurimit në rast se i Siguruari vdes për shkak të rreziqeve që nuk mbulohen nga Kushtet e Sigurimit. Në këtë rast Policëmbajtësi ka të drejtën e pjesës së primit për periudhën e mbetur, duke zbritur shpenzimet administrative.

**Juridiksioni** - Çdo kundërshti mbi këtë Polisë që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ne mes te palve, kopetente per zgjeddhjen e mosmarveshjeve eshte Gjykata Themelore e vendit ku eshte leshuar polisa.

**Përmeshja e parashikimeve të policës**- Mospërmeshja e parashikimeve të kësaj Police do t'i bëjë të pavlefshme kërkesat për përfitim.

**Korrespondenca** - Korrespondenca midis Siguruesit dhe Kontraktuesit do të zhvillohet me shkrim.

## TABELA E PËRFITIMEVE

Humbja	Përfitimi i pagueshëm në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular	%
A	Humbja e jetës	100%
B	Paaftësi e Përherhshme	
1	Paaftësi e Plotë e Përherhshme	100%
2	Humbje ose humbje e plotë e përherhshme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%
3	Humbje ose humbje e plotë e përherhshme e përdorimit të një gjymtyre	75%



4	Humbje e plotë e përhershme e shikimit në të dy sytë	100%
5	Humbje e plotë e përhershme e shikimit në një sy	75%
6	Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy	100%
7	Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%
8	Humbje e përhershme dhe e pakurueshme e shëndetit mendor	100%
9	Humbje e plotë e përhershme e dëgjimit	
	a) në të dy veshët	70%
	b) në një vesh	20%
10	Humbje e plotë e të folurës	70%
11	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	50%
	b) të majtë	30%
12	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të katër gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	30%
	b) të majtë	15%
13	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtit të madh të dorës	
	a) të dyja falangat e gishtit të djathtë	30%
	b) një falangë e gishtit të djathtë	15%
	c) të dyja falangat e gishtit të majtë	20%
	d) një falangë e gishtit të majtë	10%
14	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të tjerë	
	a) tre falanga të një gishti të dorës së djathtë	10%
	b) dy falanga të një gishti të dorës së djathtë	7%
	c) një falangë e një gishti të dorës së djathtë	5%
	d) tre falanga të një gishti të dorës së majtë	7%
	e) dy falanga të një gishti të dorës së majtë	5%
	f) një falangë e një gishti të dorës së majtë	3%
15	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës	
	a) të gjithë gishtërinjët e një këmbë	10%
	b) dy falanga të gishtit të madh të këmbës	5%
	c) një falangë e gishtit të madh të këmbës	3%
	d) seicili prej gishtave përveç gishtit të madh	1%
16	Shkurtim i këmbës me të paktën 5 cm	7%
17	Djegje të shkallës së tretë	
<b>Zona:</b>	Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit	
- koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 8%	100%
- trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 20%	100%

**KUSHTE TË VEÇANTA:**



1. Përfitimi i përgjithshëm i pagueshëm në lidhje me paaftësitë që janë rrjedhojë e të njëjtit dëmtim llogaritet duke mbledhur përqindjet e tyre por nuk do të kalojë 100% të shumës së sigurimit dhe Siguruesi nuk do të jetë më përgjegjës sipas kësaj Police për të njëjtin të Siguruar për Dëmtime Trupore Aksidentale.
2. Në rastet kur i Siguruari është mëngjërash, përqindjet e përfitimeve të pikave 11 deri 14 më sipër do të këmbehen duke pasur parasysh se përqindja më e lartë e përfitimit do të zbatohet për dorën e majtë dhe pjesët e saj.
3. Shenim: Pagesa duhet të behet brenda periudhes së caktuar nga Siguruesi, në rast të kundërt kërkesa për demshperblimi në rast dëmi mund të perjashtohet sipas "Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit".